



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0823**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) SHM Architecture SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një konkursi të projektimit të MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit të ri në Pejë, në përputhje me Kategorinë III të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadioneve, të miratuara nga UEFA” me numër të prokurimit 207-23-3988-4-1-3, me 27/12/2023, mori:

## **Vendim**

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e OE "SHM Architecture" SH.P.K. me nr. 2023/0823, e datës 21/10/2023, kurse vendimi i AK MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit të ri në Pejë, në përputhje me Kategorinë III të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadioneve, të miratuara nga UEFA” me numër të prokurimit 207-23-3988-4-1-3 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim.**

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik SHM Architecture SH.P.K.

## Arsyetim

### *- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 25.04.2023, MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Konkursin e Projektimit B06 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit të ri në Peje, në përputhje me Kategorinë III të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadioneve, të miratuara nga UEFA” me numër të prokurimit 207-23-3988-4-1-3. Ndërsa me datën 09.10.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se ofertat nuk plotësojnë kriteret administrative gjatë fazës së vlerësimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur (konkurs projektimi) me llojin e kontratës shpërblye (konkursit) dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 165.000.00 €.

Me 12.10.2023, OE SHM Architecture SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 13.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 21.10.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE SHM Architecture SH.P.K me nr. 823/23 lidhur me aktivitetin “Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit të ri në Peje, në përputhje me Kategorinë III të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadioneve, të miratuara nga UEFA” me numër të prokurimit 207-23-3988-4-1-3.

### *-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

### *- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues SHM Architecture SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendon se: *“vendimi i AK-së për diskualifikimin në këtë konkurs projektimi për shkak të mungesës së dokumenteve të kërkuara sipas dosjes së tenderit është i pabazuar. Gjithashtu, moslejimi i hapjes së kopjes së propozimit të OE ankues është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP-së)”*.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE SHM Architecture SH.P.K kërkon nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 10/11/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 823/23, ndërsa me datë 12/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0846 me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rishqyrtim”*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues duke theksuar *“duke e parë edhe procesverbalin e paraqitur nga Zyrtaret e Autorizuar dhe pas hapjes që u bere evidentimi se mungesa ne origjinal gjindet ne Dosjen – Kopje... ju paraqes si Autoritet Kontraktues pajtohem me ekspertizën e ekspertit profesional dhe se lenden do ta kthejmë ne rishqyrtim ne momentin që vjen një vendim i ngjashëm sikur ekspertiza ndërsa OE nuk është deklaruar rreth raportit t ekspertit shqyrtues.*

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE SHM Architecture SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0823 ka vlerësuar si në vijim:

Fillimisht, eksperti sqaron se në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit AK ka zbatuar procedurën e Konkursit të Projektimit, me shpërblimet si vijon: çmimit i parë në vlerën maksimale 155,000.00 Euro, çmimi i dytë në vlerë prej 7,000.00 dhe çmimi i tretë 3,000.00. Dorëzimi i propozimeve është bërë në formë fizike në Zyrën e Prokurimit në Ministrinë e Kulturës Rinisë Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente (më tej Ministria). Në dosjen e tenderit, përkatësisht Aneksin 1-Specifikimet teknike të detyrueshme në lidhje me dorëzimin AK ka kërkuar: *"Vulosja dhe shënimi i tenderëve Pjesëmarrësit duhet të dorëzojnë një [1] origjinal dhe dy [2] kopje te origjinalit: Një [1] ORIGJINAL: Një [1] origjinal i Dokumentacionit të kandidatit- në formë të shtypur; Një [1] origjinal i Dokumentacionit të kandidatit- në formë digjitale, [Një CD ose një Pajisje për ruajtje të të dhënave (Data storage device)]. Një [1] origjinal i Projektit ideor- në formë të shtypur; Një [1] origjinal i Projektit ideor- në formë digjitale, [Një CD ose një Pajisje*

*për ruajtje të të dhënave (Data storage device)]. Dy [2] KOPJE TE ORIGJINALIT: Një [1] kopje të origjinalit të Dokumentacionit të kandidatit- në formë të shtypur; Një [1] kopje të origjinalit të Dokumentacionit të kandidatit- në formë digjitale; [Një CD ose një Pajisje për ruajtje të dhënave (Data storage device)]. Një [1] kopje të origjinalit të Projektit ideor- në formë të shtypur; Një [1] kopje të origjinalit të Projektit ideor- në formë digjitale; [Një CD ose një Pajisje për ruajtje të dhënave (Data storage device)]".*

Më tej, sipas shkresave të lëndës, OE ankues ka dorëzuar një origjinal dhe dy kopje të propozimit me kodin 1861. AK, në vendimin e datës 09.10.2023 konstaton se Juria Profesionale e rekomandon anulimin e procedurës, si rezultat qe asnjëra nga shifrat (ofertat) nuk plotësojnë kriteret administrative gjate fazës se vlerësimit. Më tej në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar AK ka specifikuar arsyetimin e eliminimit për OE ankues si vijon: *"Për mos përmbushjen e këtyre kushteve si 1.3 Matricës së programit, i cili mungon 1.4 Raportit mbi qasjen dhe metodologjinë projektuese, i cili mungon. Ky projekt vlerësohet si i papërgjegjshëm."*

OE ankues me datë 11.10.2023 ka dorëzuar kërkesën për qasje në dokumentacionin e vlerësimit dhe ka kërkuar hapjen e kopjes së ofertës cila është dorëzuar së bashku me origjinalin. Në të njëjtën ditë zv. Drejtori i Prokurimit ka njoftuar palën për të drejtën e qasje ne dokumentacion e vlerësimit, por ka refuzuar mundësinë e hapjes se kopjes se aplikacionit.

Me date 12.10.2023 ka marrë raportin e vlerësimit të tenderëve ( propozimeve) por jo edhe qasjen apo mundësinë e hapjes së kopjes së ofertës. AK me datë 13.10.2023 përmes vendimit ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim. Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK ka dhënë arsyetimin si vijon: *"Zyra e Prokurimit në MKRS jep qasje aq sa e lejon e drejta për qasje ne dokumente te Prokurimit konkretisht pranoi detajet mbi qasjen ne dokumentet tuaja: I/e nderuar. Jeni te ftuar nesër ne ora 10:00 për qasja ne dokumentacionin fizik dhe vlerësimin sipas kërkesës suaj Zyra 021 MKRS. Deri nesër në këtë kohe do te analizohet Ligji dhe rregulloret për të verifikuar nëse lejohet hapja e kopjes apo jo. Bazuar në analizën e Ligjit konkretisht në nenin ku ju jeni thirrur: Neni 10. Mjetet për promovimin e Transparencës te Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, pika 8. Autoritet i kontraktues do t'i siguroje një ekspert shqyrtues. KRPP-se ose OSHP-së dhe ose një panel i shqyrtues. qasje ne kopjet e cilitdo aktivitet te prokurimit duke përfshire edhe informatat sekrete afariste dhe çfarëdo informata te tjera qe kane te bëjnë me prokurimin. menjëherë pas kërkesës se te mësipërme. Autoriteti kontraktues gjithashtu do t i siguroje qasje dhe kopje te shënimeve dhe informatave e një gjykate kompetente nëse qasja ose kopjet e tilla kërkohen nga një urdhër i nxjerre nga gjykata e tille. Autoriteti kontraktues menjëherë do te siguroje qasjen dhe kopjet e kërkuara ne mënyrë te rregullt dhe pa pengesa. Pra. ne asnjërën nga pikat nuk specifikohet qe Operatori Ekonomi mund të ketë qasje ne kopjet e tyre. Te njëjtat mund të hapen vetëm me kërkesë te OSHP-se ne momentin që kërkohet për tu hapur dosjet dhe me ndonjë vendim nga Gjykata. Matricat A3 dhe Raporti deri ne 50 faqe nuk janë bashkangjitur ne origjinalin e vlerësuar nga Komisioni Vlerësues dhe janë vërejtur ne fazën vlerësuese. Andaj pretendimi i juaj është i pabazuar. Po ashtu specifikohet qarte ne raport qe shifra 1861 - I .5-Material i ekspozues ( te përberë përkitazi nga 6 panele) - nuk është i kompletuar i Ofertuesi ka prezantuar 2 panela (pllakata ) mungojnë -1- panele (pllakate) Le përqendruara ne Projektin ideor te arkitekturës dhe inxhinierisë konstrukti e dhe 15 vizatime ne hamer kjo është shpjeguar dje nga zyrtarja monitoruese ne proces. Si i tille pretendimi nga shifra 1861 është i pabazuar."* OE ankues si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së të datës 13.10.2023 ka dorëzuar ankesë në OSHP të protokolluar me numër 2023/0823.

Me qëllim të hapjes së kopjes së ofertës, eksperti ka kërkuar përmes email-it me datë 15.11.2023 nga zv. Kryesuesja e Sekretariatit të OSHP-së formimin e një komisioni për hapjen e kopjes së ofertës me prezencën e palëve. Zv. Kryesuesja e Sekretariatit të OSHP-së me datë 16.11.2023 ka nxjerr vendimin numër 823/23 për emërimin e komisionit për hapjen e kopjes së propozimit të dorëzuar nga OE ankues me përbërje: 1.Visar Basha, 2.Kreshnik Spahiu dhe 3.Gjemajli Bellanica.

Me datë 22.11.2023, në prezencë të përfaqësuesve të OE ankues dhe përfaqësuesve nga Ministria e Kulturës, Komisioni ka bërë hapjen e kopjes së propozimit dhe është konstatuar se janë dorëzuar: *Matrica e programimit* dhe *Raport mbi qasjen dhe metodologjinë projektuese*. Në fund të procesit të hapjes është përpiluar procesverbali dhe është nënshkruar nga Komisionin dhe përfaqësuesit e Ministrisë dhe OE ankues.

Andaj, sipas fakteve dhe provave shkresore në procedurë, eksperti sqaron se në lidhje me qasjen në dokumentet e ofertës të OE ankues, përkatësisht kopjet e ofertës, AK nuk ka vepruar në përputhje me Rregulloren 001/2022 për Prokurimin Publik, Neni 31.3, në të cilin thuhet: *“Tenderi do të dorëzohet të AK në një formë të origjinalit dhe një numër të kopjeve të cilat AK i ka kërkuar në mënyrë të qartë në dosjen e tenderit. Tenderi origjinal si dhe kopjet e kërkuara do të jenë identike. Kopjet hapen në shërbim të komisionit vlerësues.”*

Më tej në lidhje me arsyet për eliminim të cekura në vendimin e AK-së të datës 09.10.2023, ashtu sikurse është sqaruar me sipër, në hapjen e kopjes së ofertës me datë 22.11.2023, në prezencë të përfaqësuesve nga AK dhe OE, komisioni i hapjes në OSHP ka konstatuar se janë dorëzuar dokumentet *“Matrica e programimit”* dhe *“Raport mbi qasjen dhe metodologjinë projektuese”*, rrjedhimisht eksperti vlerëson se pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi në raportin e ekspertit është i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues SHM Architecture SH.P.K janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK të datës 09.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit të ri në Pejë, në përputhje me Kategorinë III të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadioneve, të miratuara nga UEFA” me numër të prokurimit 207-23-3988-4-1-3, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**. Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore të nenit 1,7, 59, 62 LPP dhe Rregulloren 001/2022 për Prokurimin

Publik, pasi komisioni i hapjes në OSHP (përbërje prej tre anëtareve) ka konstatuar se janë dorëzuar dokumentet “*Matrica e programimit*” dhe “*Raport mbi qasjen dhe metodologjinë projektuese*”. Megjithatë nga shkresat e lëndës vërehet se AK po ashtu është pajtuar që kjo lëndë të kthehet në rivlersim cituar si në vijim: *Duke e parë edhe procesverbalin e paraqitur nga Zyrtaret e Autorizuar dhe pas hapjes që u bere evidentimi se mungesa ne origjinal gjindet ne Dosjen – Kopje... ju paraqes si Autoritet Kontraktues pajtohem me ekspertizën e ekspertit profesional dhe se lenden do ta kthejmë ne rishqyrtim ne momentin që vjen një vendim i ngjashëm sikur ekspertiza.*

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së. Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër, kurse AK obligohet të veproj në harmoni me këtë vendim dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues në përputhje me nenin 59 të LPP-së. Sa i përket ofertuesve tjerë të cilët nuk e kanë atakuar vendimin e AK të datës 09.10.2023 për eliminimin e tyre nga ky aktivitet i prokurimit, konsiderohen palë pa interes juridiko-material konform neni 4 pika 1.26 cituar "personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar".

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Lidhur me tarifën ankimore është vendosur konform nenit 31 paragrafi 4 dhe paragrafi 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vjosa Gradinaj**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- **OE - SHM Architecture SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: